



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/03-14367 dt. 21/04/ 2026

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit

th e r r e t

mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal, e cila do të mbahet më datë: **30.04.2026** dhe do të fillojë në orën **11:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës Drenasit.

Për mbledhje propozohet ky:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt.30.03.2026.
2. Propozim vendim për miratimin e Planit Lokal të veprimit në mjedis 2026-2030.
3. Propozim vendim për miratimin e Planit Komunal për Ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Drenasit/Glllogocit 2026-2028.
4. Propozim vendim për lejimin e bonusit të banimit për shfrytëzimin e banesave me qira nga tregu, për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare të bëjnë pagesën e qirasë.
5. Propozim vendim për caktimin e anëtareve të komisionit përzgjedhës për drejtor në institucionet publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit.
6. Propozim vendim për themelimin e komisionit për vlerësimin e pronave të përfshira në vendimin Nr.02-462/01-77929 të datës 27.02.2026 për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/Juridik (deri 99 vite) .
7. Propozim vendim për themelimin e komisionit të Ankesave për shqyrtimin e Ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës
8. Raporti Financiar Janar-Mars 2026.
9. Të ndryshme

Drenas, 21.04.2026



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Burim Bijupi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060104-14368 dt. 21/04 2026

PROCESVERBALI

I mbledhjes së rregullt të **Kuvendit Komunal të Drenasit**, mbajtur më **30.03.2026**, e cila filloi në orën **10:00**.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal, **Burim Bujupi**, i cili deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 27 anëtarë.

Në mbledhje morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendi, Burim Bujupi, anëtarët e Kuvendi, Ekrem Elshani, Naim Gjeli, Anjeza Kurtaj, Selman Qallapeku, Valdet Curri, Qëndresë Xhema, Gani Krasniqi, Edon Nishori, Erblinë Morina, Fitore Morina-Hoxha, Driton Ajazi, Arigon Sinani, Jahir Hajdari, Zeqir Hasi, Mërgim Pirraku, Muhamet Xhemajlaj, Artian Krasniqi, Tringa Bujupi, Pajtime Berisha, Luljeta Elshani, Egzona Tërdevci, Xhavit Drenori, Arbër Halilaj, Mehedin Salihu, Egzon Qorri dhe Liman Krasniqi.

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës së Drenasit, **Ramiz Lladrovci**, nënkryetari **Arben Shala**, stafi i zyrës së kryetarit dhe drejtorët e drejtorive.

Mbledhja do të ketë këtë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të datës 26.02.202;
2. Raporti i progresit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për pasqyrat financiare për vitin 2024;
3. Propozim-rregullorë për menaxhimin e dokumenteve zyrtare dhe arkivore;
4. Propozim-vendim për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për NPL "EKO-Drenasi" Sh. A. Gllogoc;

5. Propozim-vendim për themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim përmes negocimit apo shpalljes publike;
6. Propozim-vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite të pronës së paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-70315035-00848-0 në Krajkovë, me sipërfaqe 130,000 m², kapacitet 9.99 MW dhe vlerë investive 5,800,000.00 €;
7. Propozim-vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite të pronës së paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-70315035-00913-0 në Krajkovë, me sipërfaqe 92,000 m², kapacitet 5.70 MW dhe vlerë investive 3,300,000.00 €;
8. Propozim-vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite të pronës së paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-703150053-00539-0 në Negroc, me sipërfaqe 109,084 m², kapacitet 5.90 MW dhe vlerë investive 5,800,000.00 €;
9. Propozim-vendim për emërimin e përfaqësuesve të Kuvendit Komunal në Asociacionin e Komunave të Kosovës;
10. Të ndryshme.

Mbledhjen e kryesoi **Burim Bujupi**, kryesues i Kuvendit, i cili hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës. Pas miratimit të procedurave fillestare, fjalën e mori kryetari.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci kërkoi që të shtohet edhe një pikë shtesë: Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Kjo pikë ka të bëjë me dëmet në pronat bujqësore gjatë vitit 2025.

Egzona Tërdevci tha se, Meqë është i vitit 2025, pse nuk ka ardhur më herët, kur është bërë ky vlerësim.

Drejtori Nexhmedin Gruda sqaron: Gjithmonë komisioni vlerëson deri në fund të vitit. Nuk e kemi sjellë më herët, sepse i kemi dhënë hapësirë dëmeve nga vërshimet. Komisioni qendror në bashkëpunim me komisionin tonë, kanë thënë që, për të mos u përzier një herë t'i sjellim këto të vërshimeve, pastaj ta bëjmë një raport përfundimtar nga komisioni për këtë arsye edhe është vonuar.

Xhavit Drenori tha se, duhet të kemi një raport më të specifikuar, sepse votë 'blanko' si për këtë raport që keni sjellë ju, unë nuk mund të jap. Më vjen keq për çdo dëm që u është bërë këtyre personave, por ky nuk është raport, është vetëm një fletë me një shumë dhe disa emra që nuk ka përmbajtje.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovc ky raport i ka të gjitha të dhënat e detajuara dhe çdo dëm që është aty, është në sistem dhe i deklaruar në polici, domethënë, asnjë gjë nuk është e paevidentuar. Dëmet mblihen gjatë gjithë vitit dhe propozohen në vitin vijues. Nëse e vlerësoni që ta fusim në rend të ditës mirë, nëse jo, e shtyjmë për mbledhjen tjetër, por që të mos i vonojmë njerëzit për kompensimin e dëmeve nga niveli qendror, e kemi sjellë në këtë mbledhje.

Xhavit Drenori po të besoj për raportin dhe me gjithë respektin për punën tuaj, ju përgëzoj për çdo punë të mirë që bëni. Por, mos na vendosni në pozitë të keqe, vota është personale dhe kemi të drejtën e votës të votojmë ashtu siç e kemi vullnetin.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, votoni po ose jo, është vendim i juaji individual.

Drejtori Nexhmedin Gruda, komisioni i ka në dispozicion të gjitha dosjet për secilin person. **Mehedin Salihu** pyeti a janë vetëm këta 15 persona që u janë shkaktuar dëmet apo ka edhe persona të tjerë.

Mërgim Pirraku tha ne si grup konsiderojmë që duhet të hyjë si pikë e rendit të ditës dhe jam i lumtur të votoj për t'i kompensuar dëmet, sepse njerëzit janë duke pritur.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi tha se, pas diskutimeve që u zhvilluan, hidhen në votim këto pika të rendit të ditës, duke shtuar edhe pikën e propozuar nga Kryetari. Të pranishëm ishin **27 anëtarë**. Për votuan **25**, kundër **0**, abstenime **2**.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës: (1) Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal të dt. 26.02.2026. E hap për diskutim.

Egzona Tërdevci sa i përket procesverbalit, ose të bëhet transkript ku vendosen komplet fjalët e secilit, ose të përcillen më mirë fjalimet, sepse në faqen 8 nuk janë fjalët e z. Lladrovci karshi meje, është vetëm përgjigjja ime dhe kur lexohet vetëm përgjigjja ime, atëherë del shumë e pakuptimtë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se unë nuk i lexoj procesverbalet, sepse krejt çka flasim regjistrohet dhe incizohet. Për transkriptin e kemi shpjeguar, nuk bëhet vetëm kur kërkohet për tema të caktuara. Për debatet tona nuk bëhet transkript, sepse çfarëdo që keni, e keni të regjistruar dhe nuk ka nevojë të jetë në procesverbal.

Xhavit Drenori unë po ju them që, nëse për Kryetarin nuk është i rëndësishëm procesverbali, për mua është jetik. Sepse nëse pasardhësit tanë, pas disa viteve duan të shohin çka kemi folur, çka kemi diskutuar dhe si kemi votuar, unë duhet t'i kem të shkruara, pa marrë parasysh a janë vidcot. Videot edhe mund të humbin, kurse këto procesverbale do të digjitalizohen. E di që nuk është e lehtë për kolegët, por është një punë që duhet të bëhet mirë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci besoj që e kuptoni se çka është një procesverbal. Debatet për një procesverbal të mbledhjes nuk hyjnë të gjitha, por vetëm tema dhe domethënia, kurse transkripti është diçka tjetër. Për shembull, unë mund të ofendoj dikë ose dikush mund të më ofendojë mua, këto gjëra nuk kanë të drejtë të shkruhen në procesverbal. Kushdo që ka ankesa, janë organet që e drejtojnë, e ke të incizuar dhe e drejton aty. Në procesverbal nuk duhet të shkruhen mbi dy ose tre rreshta për çdo pikë të rendit të ditës, duhet të thjeshtëzohet, të zvogëlohet. Për shembull: u diskutua, u miratua, u votua (për, kundër, abstenim) dhe kaq.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi pas diskutimeve, e hodhi në votim pikën e parë, e cila kaloi. Për votuan **26**, kundër **0**, abstenim **1**.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi hapim për diskutim pikën e dytë të rendit të ditës: 2. Raporti i progresit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për pasqyrat financiare për vitin 2024.

Egzona Tërdevci tha se, po i përsëris edhe një herë dy çështje që i kam ngritur edhe në komitet.

E para, te pika B2, mungesa e projekteve ekzekutuese – a po vazhdojnë të jepen tenderë pa pasur projekte ekzekutuese. Dhe e dyta, te pika A5, mos raportimi i rregullt për pronat komunale. E kemi vendosur si të zbatuar, por raportimi nuk ka qenë në rregull çdo gjashtë muaj ashtu siç është përshkruar në raport.

Kryesuesi Burim Bujupi faleminderit znj. Tërdevci, fjalën e merr z. Drenori.

Xhavit Drenori tha se, prej të gjeturave, është njëra që nuk është zbatuar fare. Kur është çështja të këto kontratat kolektive, pra të gjitha kontratat që nuk kanë mundur të realizohen sipas planit, dëmi që i është bërë Komunës tashmë dihet. Megjithatë, këtu nuk është specifikuar mirë nga ata që e kanë bërë monitorimin se këtu mund të ketë edhe projekte kapitale, respektivisht kontrata të cilat nuk janë realizuar me kohë, dhe dëmi është se kanë kaluar përmes përmbauesve. Shuma prej 2 milionë e 488 mijë eurosh është jashtëzakonisht shumë e madhe dhe shqetësuese. Të shkojnë mbi 2 milionë euro brenda vitit përmes përmbauesit është "të lënë mendtë", sidomos kur llogaritet sipas statistikave se gjysma e tyre shkojnë për kosto procedurale. Sikur t'i gëzonte ato mjete ai nëpunës ose operator ekonomik që e ka kryer punën, do të ishte tjetër gjë, por këtu po shkaktohet një dëm i madh procedural. Përmbauesit dhe proceset gjyqësore marrin shuma të mëdha, e gjithë kjo në kurriz të qytetarëve dhe taksave tona.

Z. Kryetar, unë e kam pasur këtë debat edhe në një nivel tjetër me disa kryetarë komunash, të cilët gjithashtu janë ankuar. Ne e dimë që këto planifikime nuk mund të hyjnë lehtë në buxhet sepse mungon një "kod", si të thuash, por besoj se drejtori i Drejtorisë së Arsimit e di saktësisht se sa punëtorë do të dalin në pension. Do të ishte mirë të gjendej një lloj modusi apo marrëveshjeje me këta mësimitdhënës. Është e lehtë t'u thuash "na dërgoni në gjyq" sepse nuk kemi mundësi t'ua japim mjetet, por gjyqin ata e fitojnë. Avokatët kanë mbetur duke i fërkuar duart se kush po vjen nga komuna, ata vetëm ndërrojnë emrin, mbiemrin dhe numrin personal, pasi procedurat dhe gjyqet dihen që fitohen.

Kështu, ne e dimë që gjyqin e kemi të humbur, por me atë humbje nuk po japim vetëm pagën jubilarë, po humbim edhe kostot e procedurës. Nuk e di se kur do të sqarohet kjo çështje në nivel qendror, në Parlamentin e Kosovës, për gjë që i lutem edhe kolegës e cila ka relacione më të mira atje. Është vërtetë e padrejtë kjo që po ndodh nëpër komuna. A nuk ka asnjë mundësi që të bëhet një planifikim, në mënyrë që këto para të mos shkojnë përmes përmbauesve.

Edhe një çështje tjetër: i kam listuar këto pika dhe gjeta dy që janë pjesërisht të zbatueshme. Është interesante sfida me drejtoritë përkatëse dhe menaxherët e kontratave të cilët janë pensionuar. Më duhet një sqarim: kush janë këta zyrtarë komunalë që i kanë menaxhuar ato kontrata. Mendoj se, meqenëse jemi duke folur për drejtori komunale, nuk është e lehtë, sepse dihet kur dikush del në pension dhe puna duhet t'i kalojë dikujt tjetër.

Nuk duhet të mbetet dëmi të ne për shkak të një menaxhimi jocosifikas. Në dy-tri raste e pashë të njëjtin arsyetim, prandaj për mua ka shumë rëndësi të dihet se ku qëndrojnë sfidat dhe pse nuk janë zbatuar këto pika.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se për pyetjet e Egzonës sqaron kryetarja e komisionit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së. Sa i përket kontratave kolektive Xhavit, unë e kam paditur Qeverinë në gjykatë, sepse barra mbi ne nuk është barra jonë. Dëmet janë të mëdha nga kjo kontratë kolektive. Qeveria nuk na pyet se ku t'i marrim paratë, përmbauesi vendos vetë.

Liridona Durmishi sqaroi se, sa i përket çështjes B2- mungesa e projekteve ekzistuese - për projekte të mëdha i kemi të gjitha projektet, ndërsa për projekte të vogla kostoja duhet të jetë 3 për qind e vlerës së investimit të projektit. Për këto të fundit nuk kemi projekte, por vazhdojmë me paramasë. Sa i përket çështjes A5, ju njoftojmë se, zyrtari ka raportuar dhe për këtë arsye kemi thënë që është i zbatuar.

Liman Krasniqi tha se, të çështja A3, shpërblimi me kontratë në mungesë të plotësimin të kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit, kam një kërkesë për zyrtarët e prokurimit që kriteret t'i vendosin në harmoni me dosjen dhe punët që kanë për t'u kryer. Të mos vendosen kriteret të paarsyeshme, por të thjeshtohen dhe t'u jepet mundësia më shumë kompanive që të konkurrojnë, për hir të çmimit dhe kualitetit të punës.

Liridona Durmishi sqaroi se për çështjen A3, shpërblimi me kontratë, Zyra e Prokurimit dhe komisioni vlerësues do të marrin masa që të mos neglizhohet dhe shpërblimi me kontratë të bëhet sipas kriterëve që janë paraparë. Ky rekomandim është i zbatuar.

Liman Krasniqi kërkoi që të mos vendosen kriteret të paarsyeshme, në mënyrë që të mos ketë pengesa në zbatim.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se, për kriteret në mbikëqyrem nga KRPP-ja dhe nga OSHP-ja. Unë besoj që kriteret i kemi në harmoni me ligjin. Se kush i fiton, e vlerëson komisioni dhe vendos.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi pasi ky është raport dhe nuk votohet, vazhdojmë me pikën e tretë. Kryesuesi hapi për diskutim pikën e (3): Propozim-rregullore për menaxhimin e dokumenteve zyrtare dhe arkivore. Fjalën e merr Bekim Morina.

Bekim Morina tha se, për hartimin e kësaj rregulloreje është formuar një komision, i cili e ka kompletuar rregulloren. Ajo përbëhet nga 15 nenc të ndara në paragrafë e nënparagrafë. Arsyeja e propozimit të rregullores është arkivimi, administrimi, menaxhimi, protokollimi dhe klasifikimi zyrtar i dokumentacionit që nga evidentimi fillestar, deri në arkivimin e tyre në formë fizike dhe elektronike dhe asgjësimi i dokumenteve arkivore në Komunë.

Xhavit Drenori tha se, pika 02 qenka sqaruar prej kolegës, nuk kam diçka tjetër. Vetëm ju përgëzoj për punën.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci e falënderoj komisionin për punën e jashtëzakonshme që kanë bërë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi pasi nuk pati diskutime tjera e hodhi në votim pikën e tretë. Për votuan 27, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e katërt (4): Propozim-vendim për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për NPL "EKO-Drenasi" Sh.A. Glllogoc. Siç e dini, ky komision përbëhet nga tre anëtarë: një nga ekzekutivi dhe dy nga anëtarët e Kuvendit. Mandati i anëtarëve përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit.

Arbër Halilaj kisha sugjeruar që, kur formojmë komisione të mos shikohet gjithmonë vetëm përfaqësimi i bazuar në votat në Asamble, por profesionalizmi dhe ekspertiza e asamblistëve. Duke parë natyrën e punës së këtij komisioni, propozoj që një nga anëtarët të jetë Xhavit Drenori, pasi ai merret me problematika mjedisore, siç është projekti 'Green për Drenasin'.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se edhe nga grupi ynë është i disponimit për ta propozuar Xhavit Drenorin. Jo vetëm në këtë komision, por edhe në komisione të tjera ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me të gjithë.

Gani Krasniqi nga PDKRLL, propozon Xhavit Drenorin për shumë arsye.

Driton Ajazi tha se, e përgëzoi kryetarin për themelimin e kompanisë "EKO-Drenasi", sepse me të vërtetë Drenasi ka pasur nevojë për një kompani që e di përgjegjësinë dhe llogaridhënien, punën apo mospunën dhe që u ofron shërbime efikase qytetarëve. Ndërsa për anëtar të komisionit, ai propozoi Driton Ajazin.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi vazhdoi mbledhjen pas pesë minutave pauzë ku kryetari nga ekzekutivi propozoi si anëtarë Laureta Thaqin. Kryesuesi prezantoi përbërjen e këtij komisioni.

-**Xhavit Drenori** dhe **Driton Ajazi** (anëtarë nga Kuvendi);

-**Laureta Thaqi**, anëtare (nga ekzekutivi).

Me anëtarët e prezantuar, kryesuesi e hodhi në votim pikën e katërt. Propozim-vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPL "EKO-Drenasi" Sh. A. Gllgoc. Për votuan **27**, kundër **0**, abstenim **0**.

Egzona Tërdevci uroi anëtarët e komisionit dhe theksoi që ky komision duhet të raportojë çdo gjashtë muaj në Kuvend, që të mos përsëriten praktikat si në mandatet e kaluara.

Xhavit Drenori i falcminderoi shumë për këtë detyrë. Unë e marr si përgjegjësi, jo si privilegj. E kam cekur edhe më herët që jam në gjendje të marr detyra, sepse për këtë arsye kam ardhur këtu. Egzona ka të drejtë që kërkon raport për punën dhe përgjegjësitë që ne marrim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e pestë të rendit të ditës: (5). Propozim-vendim për themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave komunale për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë.

Ky komision do të ketë për detyrë ofrimin e rekomandimeve për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim, përmes negocimit apo shpalljes publike.

Gjithashtu, kryesuesi bëri të ditur se, pas një koordinimi paraprak me shefat e grupeve parlamentare, është arritur dakordësia që numri i anëtarëve të këtij komisioni të rritet nga 9 në 11.

Egzona Tërdevci tha se, nuk e di kuptimin e krijimit të një komisioni për listën e pronave që do të jepen në shfrytëzim, kur ne paraprakisht e kemi miratuar atë listë. Më duket se po veprojmë në retrospektivë, ky komision do të duhej të formohej para se të miratohej vendimi paraprak, në mënyrë që të përcaktonim cilat prona duam t'i japim në shfrytëzim. Të gjitha pronat që kanë

kaluar deri tani kanë qenë afatgjatë, ndërsa tani flitet për afatshkurtër. Na i keni ngatërruar pak gjërat me këtë mënyrë pune.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci edhe në mbledhjen e kaluar kam kërkuar që të formohet ky komision për të shqyrtuar, rekomanduar dhe negociuar çdo pronë që mund të sjellim në Kuvend. Për pronat me negociim, komisioni do të ketë autorizimin tim që të bisedojë me palët e interesuara. Ndërsa për pronat me shpallje publike nga lista paraprake, ju si komision keni lirinë e plotë të vlerësoni se cilën dëshironi të procedoni. Prandaj ky komision përbëhet nga 11 anëtarë, që të shqyrtojmë e të rekomandojmë drejt, pasi kjo bëhet për zhvillimin e Komunës.

Egzona Tërdevci propozimi im është që të neni dy të shtohet një pjesë ku detyrë e këtij komisioni të jetë: shqyrtimi i listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale, trajtimi i kërkesave dhe propozimeve që vijnë për këto prona, si dhe paraqitja e arsyeve dhe interesit publik për t'i rekomanduar kryetarit. Pjesa tjetër e propozimit të mbetet e njëjtë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci unë pajtohem, Egzonë, i shtojmë edhe këto tri-katër fjali të propozim-vendimi dhe jemi në rregull.

Xhavit Drenori kur e kam votuar këtë listë para një muaji, kam rrezikuar që ndryshova mendimin nga janari. Ishin dy pika kryesore: e para, që të mos kufizohen pronat në 99 vite dhe e dyta, të formohet ky komision. Në si asamblistë kemi dy argumente për të mbrojtur interesin e qytetarëve, ose të bazohemi në 'llafet e kafeve', ose të bëhemi pjesë e komisioneve dhe t'i lexojmë materialet. E falënderoj kryetarin që u tregua zemërgjerë duke i bërë 11 anëtarë të komisionit. Tani c'jani të ulemi dhe të mos i etiketojmë të tjerët si 'të shitur' apo 'të blerë'. Do të ishte mirë të tregonim kujdes dhe të mos e fyejmë njëri-tjetrin vetëm pse dikush merr një vendim që mund të mos ju pëlqejë.

Arbër Haliaj propozim-vendimin e kam kuptuar si një qasje drejt transparencës lidhur me çështjen e dhënies në shfrytëzim të pronave komunale. Duke u ndërlidhur me propozimin e Egzonës, të neni 2 kisha shtuar edhe këtë: komisioni të ketë për detyrë prioritizimin e aktiviteteve biznesore. Domethënë, të analizohet nëse kemi të bëjmë me një operator ekonomik që merret me prodhim, shërbime apo tregti, dhe të rekomandohet se cilit duhet t'i japim prioritet në marrjen e pronës në shfrytëzim. Këtë si shtesë mund t'ia dërgoj edhe sekretarisë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci vetëm dakordohuni ju se çfarë po doni të shtoni në vendim dhe i dërgoni të sekretaria e Kuvendit.

Gani Krasniqi tha se, nga PDK-RLI propozojmë: Burim Bujupi (kryesues), Naim Xheli dhe Valdet Curri. Nga grupi i PDK-së, Driton Ajazi propozon Muhamet Xhemajlin Zeqir Hasin. Nga VV Egzona Tërdevci propozon Xhavit Drenorin, Egzona Tërdevcin, si dhe Arbër Haliajn (BD), Egzon Qorin (LDK), Liman Krasniqin (NISMA) dhe Mehedin Salihun (Për Drenasin e Kosovën).

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi prezantoi përbërjen e këtij komisioni: Burim Bujupi, Naim Xheli, Valdet Curri, Muhamet Xhemajli Zeqir Hasi, Egzona Tërdevci, Xhavit Drenori, Arbër Haliaj, Egzon Qorri, Liman Krasniqi, Mehedin Salihu. Kryesuesi e hodhi në votim pikën e pestë të rendit të ditës. (5). Propozim-vendim për themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim përmes negocimit apo shpalljes publike, me disa ndryshime që kërkojnë të bëhen të neni dy Egzona dhe Arbëri. Për votuan 27, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e gjashtë: (6). Propozim-vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-70315035-00848-0, në Krajkovë, me sipërfaqe 130,000 m², kapaciteti 9.99 MW, vlera investive 5,800,000.00 €.

Egzona Tërdevci tha se, unë i kam disa dilema për t'i votuar këto pika. E para është se kjo kompani e ka prodhimin e energjisë si aktivitet biznesor të 12-tin. Unë kam hyrë, kam hulumtuar në ZRRE dhe kam parë që kompanitë e tjera që kanë marrë licenca e kanë ose aktivitet të parë ose të dytë prodhimin e energjisë, jo të 12-tin. Edhe të regjistri publik i ZRRE-së, kjo kompani nuk figuron të të licencuarit, as të ata që janë në pritje. Unë mendoj se, meqë ia kemi dhënë një pronë në tetor të vitit 2023, ishte dashur të paktën të figuronte në listën e pritjes, prandaj këto dilema duhet të sqarohen.

Driton Ajazi tha se, edhe unë e kam shqetësimin e njëjtë si Egzona, që kompania në fjalë nuk e ka parësor prodhimin e rrymës, përderisa po kërkon të prodhojë energji elektrike për 35 vite. Por, edhe një shqetësim tjetër është që kjo kompani për degën në Kosovë, e ka të shkruar 'Balkan' – nuk e di arsyen pse 'Balkan' e jo 'Kosovë'. Duke u ndërlidhur me këtë pikë, desha të di pse kompanisë gjermane 'Starteg', që prioritet e kanë pasur prodhimin e energjisë elektrike, nuk iu ka dhënë pëlqimi. Edhe pse kanë dashur të investojnë në pronë private rreth 5 milionë euro dhe rreth 78 MW kanë pasur për të prodhuar energji elektrike përmes solarëve, ndërsa këtu i jepet një kompanie që po duhet t'i japim pronë komunale për të njëjtën çështje. A keni dashur ta eliminoni konkurrencën apo çka është në pyetje? Sa i përket kësaj çështjeje, ne jemi për investime në komunën tonë.

Xhavit Drenori tha se, paraprakisht më duhet t'i ngre disa çështje. E para: Në parim, si ambientalist – pra dashamir i mbrojtjes së mjedisit, dhe nga përgjegjësia e subjektit tim politik 'GREEN për Drenas', e përkrah çdo nismë që ka të bëjë me projekte të energjisë së ripërtëritshme. Megjithatë, duke qenë se sot kemi përpara një propozim-vendim për të cilin duhet të votojmë, dhe duke e pasur parasysh se përgjegjësia imc si asamblist është e madhe karshi qytetarëve që përfaqësoj, e konsideroj të domosdoshme që para vendimmarrjes të kemi një qartësi të plotë mbi të gjitha elementet e kësaj marrëveshjeje. Duke i marrë parasysh të gjitha dokumentet që na janë prezantuar – propozim-vendimin, procesverbalin e takimit dhe kërkesën e kompanisë – vlerësoj që kemi një bazë më të plotë informacioni, por gjithsesi mbeten disa çështje që kërkojnë sqarim shtesë për të garantuar se ky projekt është në interesin më të mirë të Komunës.

Së pari sa i përket aspektit financiar dhe përfitimit për Komunën:

-Nga procesverbali kuptojmë se qiraja planifikohet të jetë 1,000 euro për megavat në vit, për një kapacitet prej 5.70 MW. Kjo nënkupton një përfitim relativisht të kufizuar vjetor për Komunën. A është bërë një analizë krahasuese me projekte të ngjashme për të parë nëse kjo është ofertë konkurruese dhe në përputhje me tregun.

-Duke qenë se kontrata është 35-vjeçare me mundësi vazhdimi, a është paraparë ndonjë rishikim më substancial i kushteve gjatë kësaj periudhe, përtej indeksimit me inflacion.

Së dyti, lidhur me projektin dhe specifikat teknike:

-Në dokumente përmenden kapacitete të ndryshme (5.70 MW dhe 9.99 MW). A mund të na jepet një sqarim përfundimtar mbi kapacitetin real të projektit;

-Nga kërkesa e kompanisë kuptohet se projekti është zgjeruar dhe lidhet me infrastrukturën e transmetimit 220KV. A ka ndonjë ndikim shtesë ky element në territorin e komunës dhe a është trajtuar kjo në analizat përkatëse.

Së treti, për përfitimet konkrete për komunitetin:

-Kompania ka shprehur gatishmëri për punësim të banorëve lokalë dhe përparësi për nënkontraktorët lokalë. A do të përfshihet kjo si obligim kontraktual i detyrueshëm;

-Duke qenë se pas ndërtimit parashihen vetëm 4-5 vende pune të përhershme, a është vlerësuar nëse ky projekt sjell një ndikim të mjaftueshëm ekonomik për Komunën;

-Sa konkrete dhe të garantuara janë elementet e sponsorizimit për sport dhe kulturë.

Së katërti, aspekti procedural dhe i barazisë:

-Duke qenë se projekti ka ardhur si kërkesë e drejtpërdrejt nga kompania dhe është trajtuar përmes negocimit, a ka pasur interesim nga operatorë të tjerë dhe a është shqyrtuar mundësia e një procedure më konkurruese;

-A ekziston ndonjë vlerësim i pavarur profesional që e mbështet këtë marrëveshje si opsionin më të favorshëm për Komunën.

Së pesti, aspekti mjedisor dhe i komunitetit:

-A është kryer vlerësimi i ndikimit në mjedis për këtë projekt, sidomos duke pasur parasysh edhe lidhjen me rrjetin e tensionit të lartë;

-Duke qenë se projekti realizohet në zonën e Krajkovës dhe afër vendbanimeve, çfarë masash konkrete janë paraparë për mbrojtjen e banorëve dhe mjedisit;

-A janë zhvilluar konsultime me banorët e zonës.

Së gjashti, aspekti juridik dhe obligimet e Komunës:

-Në dokumente përmendet se Komuna mund të ketë obligim të sigurojë qasje dhe infrastrukturë shtesë. A është bërë një vlerësim i kostos për Komunën dhe si justifikohet kjo në raport me përfitimin;

-Çfarë ndodh me pronën komunale pas përfundimit të kontratës 35-vjeçare;

-A ka garanci të mjaftueshme për realizimin e projektit dhe për mbrojtjen e Komunës në rast të mosrealizimit.

Në fund, dua të theksoj se e mbështes fuqishëm zhvillimin e energjisë së pastër dhe investimet në këtë drejtim. Por, duke e pasur parasysh përgjegjësinë që kemi ndaj qytetarëve, është thelbësore që çdo vendim i tillë të jetë i bazuar në transparencë të plotë, analiza të qarta dhe garanci konkrete për interesin publik afatgjatë. Prandaj, kërkoj nga ekzekutivi që këto çështje të sqarohen para votimit, në mënyrë që vendimarrja jonë të jetë sa më e përgjegjshme dhe e informuar.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci iu përgjigj Egzonës, Licencimi bëhet i fundit në ZRRE, prandaj ne ua kemi dhënë afatin atyre dhe ka afat. Nuk e di a është licencuar sepse nuk është çështje e imja, ajo është çështje e institucioneve përkatëse. Thatë se e ka biznesin e 12-të me radhë, domethënë që është kompani e fuqishme dhe ka hyrë edhe në këtë drejtim për të investuar. Ju e dini që kushdo që vjen për të investuar, e ka një garanci bankare të investimit që të mos mund të tërhiqet lehtë. Për sigurimin e investimit, rishikimin e indeksit dhe inflacionit, e kemi në procesverbal, e kemi bërë që, në qoftë se ka rritje të inflacionit, do të ketë rritje, e nëse ka rënie, do të ketë zbritje. Sa i përket subvencioneve, ne kemi arritur ta bindim kompaninë që 10% të tatimit në fitim ta sponsorizojë për sportin në komunën tonë. Sa i përket punësimit, kemi diskutuar me asambleistët dhe me komisionet. Ata që kanë negociuar i kanë shpjeguar çdo detaj që kemi ngritur ju, deri tani janë të sqaruara. Mbetet në dorën tuaj të votoni për ose kundër.

Xhavit Drenori pse 1,000 euro e jo 500 p.sh.? A ka diçka ku jeni bazuar, sepse unë jam i painformuar totalisht me këtë fushë. Unë gëzohem që ka projekte të tilla, sepse kalimi prej formës së djegies për të prodhuar energji, në prodhim të energjisë së ripërtëritshme prej solarëve dhe diellit, për mua është lajm i mirë. Për mua është i rëndësishëm përfitimi në fund. Mos harroni të diskutoni edhe për çështjen e investimit, a ka ndonjë obligim Komuna të bëjë rrugë ekstra? Sepse nëse duhet të bëjmë shumë investime për infrastrukturë, nuk e di a kemi fitim prej asaj.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se, për çështje të çmimit të përgjigjet Arbeni, por besoj që çmimin më të mirë në rajon e kemi marrë ne. Sa i përket infrastrukturës, nuk kemi asnjë obligim ligjor sepse nuk janë përgjegjësi e jona, por janë përgjegjësi e ZRRE-së. Pa i marrë pëlqimet ambientale nuk mundesh as të aplikosh. Nuk ka pasur kërkesë tjetër zyrtarisht. Sa i përket pyetjes së Dritonit, është investim në pronë private, në pronë që e ka shitur AKP-ja. Janë disa procedura që duhet t'i kalojë. Prona e AKP-së është pronë bujqësore e kategorisë 4-3-5, është pronë që ka marrë subvencione për zhvillim të bujqësisë në ndërtim të serave të ndryshme. Nuk mundesh ta kalosh një investim që e ke marrë prej nivelit qendror në diçka tjetër.

Njëri prej kërkuesve, sepse tre pronarë i ka ndërruar, njëri prej tyre ka buxhet të deklaruar 20 mijë euro, pra duhet të bëhet ndryshimi, duhet të paguhet kategorizimi prej pronës bujqësore në pronë të zhvillimit ekonomik. Është bukur shtrenjtë, duhet të bëhen disa procedura për të ardhur deri të pëlqimi. Nuk ka më pëlqim si përpara, t'ia japësh pa i ndjekur procedurat, prandaj Driton, në Makresh nuk i ka plotësuar kriteret. Ne shqyrtojmë dokumente, prandaj nuk ia kemi dhënë pëlqimin, sepse duhet të ndiqen një sërë procedurash në Komunë para se të merret një pëlqim prej anës tonë. Në qoftë se kategoria e pronës është bujqësore, duhet të paguhet 1 euro për metër katror për kthimin nga toka bujqësore në pronë të zhvillimit ekonomik.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi së pari sqaron nënkryetari për çmimin, pastaj vazhdojmë.

Nënkryetari Arben Shala tha se, qiraja e ofruar dhe e kërkuar është pesëfish më e lartë se mesatarja e tokës bujqësore në Bashkimin Evropian. Domethënë, atje është diku 199 euro ose 200 e diçka, kurse ne e kemi marrë 1,000, besoj që është e kënaqshme.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci Xhavit, plus-minus aty diku është për megavat, nëse janë 40 hektarë, janë 40 megavat, ne i marrim 40 mijë euro.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi respektojeni hierarkinë! Edhe nëse kryetari ju përmend emrin, paraprakisht duhet të kërkonte replikë nga unë për të marrë fjalën.

Xhavit Drenori e thashë te çmimi, sepse ka projekte të cilat kanë impakt direkt të qytetarët, ndërsa ky jo, sepse lidhet në trasenë e tensionit të lartë dhe rryma shkon në KEK, e KEK-u na e shet neve sa të dojë. Domethënë, përfitim prej asaj që prodhon nuk kemi, përveç financimit që e përmendët të aspekti sportiv. Prandaj, ne duhet të kemi shumë kujdes, sepse biodiversiteti dëmtohet në atë pjesë ku do të montohen solarët.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci mos thoni që nuk ka përfitim për qytetarët, sepse 1,000 euro janë për megavat.

Driton Ajazi e përmendi kryetari që njëri prej investitorëve i ka pasur 20 mijë euro në llogari. Unë nuk i di detajet se sa kanë pasur para në llogari, por ajo që ka qenë publike është se konsorciumi 'Starteg' ka pasur të planifikuar një investim prej 50 milionë eurosh me një kapacitet prej 75 megavatesh, që i bie katërfish më shumë se sa ky investitori. Toka ka qenë bujqësore, klasa 4-5 dhe kur është klasa e tokës 4-5 me sa di unë, nuk është e nevojshme të bëhet ndërrim destinimi. Ata kanë qenë të gatshëm ta bëjnë, por nuk iu është dhënë mundësia. Sa i përket fshatit Sankoc, projektin për ndriçim ta përfundoni në të gjithë lagjen.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci ju po thoni Driton me kaluar në krahun e privatit, të privati, sepse është tokë private dhe bujqësore, në hartën zonale njihet ashtu dhe e sqaroi për publikun që prona publike është interes i publikut dhe është në dorën e juaj me votua për ose kundër.

Egzona Tërdevci kërkoi nga kryesuesi të ketë një rol më unifikues dhe pati dy replika në raport me përgjigjet që mori nga kryetari. Unë mendoj që duhet të interesojë a ka licencë kompani a nuk ka, sepse nëse nuk ka ky nuk mundet të prodhojë energji dhe nuk mundet të t'i paguajë as ty 1000 euro për megavat. Po ashtu, edhe fakti që e ka si aktivitet të 12 prodhimin e energjisë nuk tregon që është kompani e fortë, sepse kjo kompani është regjistruar në vitin 2023. Është dashur të kërkohen informacione zyrtare prej ZRRE-së nëse është në procedurë të licencimit, sepse nëse nuk është e licencuar dhe as në listë të pritjes, këtu diçka mungon. Kërkoj nga ju, si kryetar, të merrni informacione zyrtare nga ZRRE-ja nëse vërtet ky operator ka aplikuar për leje për prodhim të energjisë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi u sqarua se fjalët e tij ishin thënë në formë shakaje dhe jo me qëllim ofendimi.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci kërkoj falje në emrin tim dhe në emër të kryesuesit. Jemi njerëz dhe bëjmë gabime, gjë që është njerëzore. Sa i përket kompanisë, ekzistojnë disa procedura që duhet të ndiqen radhazi dhe ato i kanë afatet e tyre. Është normale që kanë aplikuar, sepse ZRRE-ja nuk i licencon deri në fund për tre vjet. Fillimisht, kompania

është regjistruar në ARBK dhe tani është në proces. Kërkoj falje nëse kam thënë që nuk më intereson se a është licencuar kompania apo jo, sigurisht që kanë aplikuar, por duhet shikuar sepse mbase është regjistruar me ndonjë emër tjetër.

Nënkryetari Arben Shala tha se, vetëm dua të sqaroj se për prodhim nuk nevojitet licencë.

Petrit Gashi, drejtor i Urbanizmit sqaroi, jo vetëm ajo kompani, por secila kompani që prodhon mbi 10 megavat dhe i nënshtrohet nivelit qendror, duhet të marrë të paktën pesë pëlqime nga pesë ministri të ndryshme para se të aplikojë në ZRRE.

Në momentin që ZRRE-ja jep vendimin final, nuk ka listë pritjeje, por vetëm pranim ose refuzim të kërkesës. Me sa kam informacione, atyre u është caktuar lokacioni për vendosjen e trafos, si dhe pëlqimi për infrastrukturën rrugore (për kyçje në autostradë) që lëshohet nga Ministria e Infrastrukturës. Me këto dokumente përfundon procedura dhe merret vendimi nga ZRRE-ja.

Egzona Tërdevci bëri pyetje: A mundeni që zyrtarisht, si Komunë, të kërkonit informacion se në cilën fazë të aplikimit është TDI-ja, a është të lejet e ministrisë apo në ZRRE.

Xhavit Drenori bëri pyetje: Te çështja e parë që e ngrita, ku qiraja planifikohet të jetë 1000 euro për MW, a janë këto mjete që i marrim vetëm nëse kompania prodhon, apo vetvetiu për kapacitetin që ajo ka, sepse në qoftë se ajo kompani nuk prodhon, atëherë ne nuk marrim asnjë cent. Nëse kjo gjë nuk është e specifikuar, ju lutem që në kontratën përfundimtare ta përfshini këtë pjesë, që të përcaktohet nëse e marrim qiranë edhe nëse kompania nuk prodhon.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci deklaroi: Askush nuk mund të marrë pronë, ta mbajë për 10 vite dhe të mos investojë asgjë. Në qoftë se kompania nuk prodhon, Komuna ia merr pronën së bashku me të gjitha pajisjet që i ka. Ju e dini që me vendim të njëanshëm mund t'ia shkëpusim kontratën çdokujt që nuk paguan qiranë kjo është e përcaktuar me ligj.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi hodhi në votim pikën e gjashtë të rendit të ditës Pasi nuk pati diskutime të tjera për këtë pikë. 6. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (për 35 vite) të pronës së paluajtshme të Komunës, përmes procedurës së negociimit të ofertës, për parcelën P-70315035-00848-0 në Krajkovë, me sipërfaqe prej 130,000 m², kapacitet 9.99 MW dhe vlerë investimi prej 5,800,000.00 €. Për votuan **23**, kundër **2**, abstenim **1**.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e shtatë (7): Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (për 35 vite) të pronës së paluajtshme të Komunës, përmes procedurës së negociimit të ofertës, për parcelën P-70315035-00913-0 në Krajkovë, me sipërfaqe 92,000 m², kapacitet 5.70 MW dhe vlerë investive 3,300,000.00 €. Pasi nuk pati diskutime për këtë pikë, kryesuesi e hodhi atë në votim. Për votuan **23**, kundër **2**, abstenim **1**.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e tetë (8): Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (për 35 vite) të pronës së paluajtshme të Komunës, përmes procedurës së negociimit të ofertës, për parcelën P-703150053-00539-0 në Negroc, me

sipërfaqe 109,084 m², kapacitet 5.90 MW dhe vlerë investive 5,800,000.00 €. Pasi nuk pati diskutime për këtë pikë, Kryesuesi e hodhi atë në votim.
Për votuan **23**, kundër **2**, abstenim **1**.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e nëntë (9): Propozim-vendim për cmërimin e përfaqësuesve të Kuvendit Komunal në Asociacionin e Komunave të Kosovës. Kryesuesi tha: Siç e dini, neve si Kuvend na takojnë tre anëtarë, sepse për çdo dhjetë anëtarë të Kuvendit, një anëtar shkon në Asociacion.

Gani Krasniqi (PDK-RLL): Deklaroi se nga grupi i tyre nuk kanë ndonjë propozim.

Driton Ajazi (PDK): Propozoi Artian Krasniqin për anëtar të Asociacionit.

Xhavit Drenori (GREEN): Në emër të grupit, propozoi Egzona Tërdevcin nga radhët e VV-së. Ai shtoi se ky propozim vjen nëse janë të pajtimit edhe grupet e tjera.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi prezantoi përbërjen e propozuar të përfaqësuesve të Kuvendit Komunal në Asociacionin e Komunave të Kosovës, si në vijim:

1. **Artian Krasniqi**, anëtar (PDK),
2. **Egzona Tërdevci**, anëtar (VV),
3. **Xhavit Drenori**, anëtar (GREEN).

Pas prezantimit të emrave të anëtarëve, **kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi**, hodhi në votim pikën e nëntë (9). Për votuan **26**, kundër **0**, abstenim **0**.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi hapi për diskutim pikën shtesë: Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Kjo pikë ka të bëjë me dëmet e shkaktuara në sektorin e bujqësisë gjatë vitit 2025.

Drejtori i Shërbimeve Publike, Nexhmedin Gruda tha se, meqenëse në scancën e kaluar nuk është lejuar shqyrtimi i dosjes së të dëmtuarve nga vërshimet, tani mund ta shihni atë, pasi dosjen e kemi këtu me vete.

Mehedin Salihu bëri një pyetje për drejtorin. A ka persona që kanë aplikuar për dëme e që nuk janë përfshirë në këtë raport? Për shembull, nëse dikujt i është shkaktuar dëm në bujqësi, ju keni ndarë vetëm një individ. Po marr shembull rastin në Shtuticë, nuk është e mundur t'i bëhet dëm vetëm një individ, pasi nuk mund të dëmtohet vetëm një arë (parcelë) e të tjerat jo.

Drejtori i Shërbimeve Publike, Nexhmedin Gruda në bazën tabelare që po shihni, nuk bëhet fjalë vetëm për vërshimet, por edhe për dëmet nga breshëri (kokrriza). Dosja është këtu, mund ta merrni dhe ta shihni saktë vlerën e llogaritur nga komisioni.

Mehedin Salihu pyetja është kjo: Ju keni vetëm 15 persona në listë për dëmshpërblim. A ka njerëz të tjerë që kanë aplikuar dhe kanë mbetur pa u përfshirë në këtë listë.

Drejtori i Shërbimeve Publike, Nexhmedin Gruda tha se, ky është numri i plotë i kërkesave dhe mbi këtë bazë është hartuar raporti, nuk kemi pasur kërkesa të tjera.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi hodhi në votim pikën shtesë të rendit të ditës: Pika shtesë: Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera (Raporti ndërlihet me dëmet e shkaktuara në pronat bujqësore gjatë vitit 2025).
Për votuan **24**, kundër **0**, abstenim **2**.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e dhjetë (10): Të ndryshme.

Egzona Tërdevci ngriti katër çështje:

- 1. Mbështetja për fëmijët me sindromën Down:** Pyetja e parë është për Kryetarin. Edhe në scancën e kaluar, edhe në komitete, kam kërkuar të dihet se cilat janë mundësitë për mbështetjen e njëhershme financiare për këtë kategori.
- 2. Memorandumi me 'Ibër Lepencin':** A është në plan që edhe këtë vit, si vitin e kaluar, të nënshkruhet memorandumi për ujitjen e tokave bujqësore.
- 3. Riparimi i rrugës në Baicë:** Ilyrja e rrugës për në fshatin Baicë është dëmtuar rëndë. Kam pranuar shumë shqetësime nga qytetarët, a është në plan riparimi i kësaj rruge.
- 4. Problemi i fermerëve të qumështit:** Pyetja e fundit është për drejtoreshën e Bujqësisë. Fermerëve të qumështit në Drenas ka filluar t'u kufizohet sasia e grumbullimit të qumështit (nuk po u pranohet e gjithë sasia si më parë). A jeni në dijeni si Komunë për këtë çështje dhe çfarë po ndërmerri.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci deklaroi: Lidhur me çështjen e fëmijëve me sindromën Down, dua të jem real, për shkak të ngarkesave ende nuk i kam konsultuar financat, nëse kemi mundësi t'i mbështesim financiarisht. Pas përfundimit të mbledhjes, do të flas me drejtorinë përkatëse dhe do t'ju informoj. Sa i përket ujitjes së tokave, unë i kam kërkuar drejtoreshës që ta heqë nga plani, sepse kemi paguar shuma të mëdha, ndërsa qytetarët nuk e kanë shfrytëzuar ujitjen ose nuk kanë aplikuar fare. Për rrugën në Baicë, kërkoj nga drejtori Endrit Gllareva që të japë sqarime, ndërsa për fermerët e qumështit, ata vazhdimisht kanë kërkuar subvencionim edhe nga Komuna. Mirëpo, dy subvencionime nga i njëjti buxhet (publik) nuk lejohe, pasi ata subvencionohen nga niveli qendror, ne si Komunë nuk kemi mundësi ligjore t'i subvencionojmë për të njëjtën gjë.

Drejtori i Shërbimeve Publike, Nexhmedin Gruda deklaroi: Drejtoria jonë e ka kontratën për mirëmbajtjen e rrugëve dhe kemi paraparë disa rrugë për t'i rregulluar. Megjithatë, duhet t'i shikojmë mundësitë tona buxhetore se sa na lejojnë, sepse aktualisht nuk kemi mjetet të mjaftueshme, pasi gjatë vitit të kaluar kemi pasur shumë dëmtime (ndërhyrje).

Egzona Tërdevci sa i përket pyetjes që adresova për grumbulluesit e qumështit, kërkoj që drejtoresha të më kthejë përgjigje me shkrim, ndërkaq për çështjen e ujitjes, unë mendoj se ajo duhet të subvencionohet përsëri, pasi fermerët e kanë mirëpritur shumë këtë iniciativë. Më vjen mirë që qenka planifikuar rregullimi i rrugës për në Likoshan, mirëpo edhe rruga për në Negroc është në gjendje shumë të keqe. Ajo rrugë është në buxhet, por dëshiroj të dijë se, a është paraparë vetëm riparimi i saj, apo rregullimi i plotë i ri.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci ka njoftuar se kemi lidhur kontratën për rrugën e Negrocit dhe besoj se ajo do të bëhet rrugë e re. Ndërkaq, rruga e Likoshanit është riinvestim i nivelit qendror; punimet kanë nisur dhe kanë arritur deri në Qikatovë. Jemi në proces e sipër edhe për atë pjesë.

Egzona Tërdevcin si pjesë e institucionit të Komunës së Drenasit, edhe mua më vjen keq kur vizitohet një vend si Likoshani, i cili ka aq shumë viktime, dhe shoh që e kemi lënë rrugën në atë gjendje. Më vjen mirë që, megjithatë, është vendosur të investohet. Sa për informacion, i cilit vit është kontrata e nivelit qendror.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se, në vitin 2016–2017 ka qenë në proces krejt rruga dhe e kanë ndalë në Qikatovë. Në 2018–2019, nuk e di saktë kohën, u shtrua pjesa e fundit. Rruga është ndërtuar keq prej fillimit dhe është zonë ku lagështia e shkatërron, ne nuk kemi pasur buxhet me vazhdu.

Naim Xheli tha se, unë mendoj që renovimi nuk është i mirë me iu bërë asaj rruge, sepse bazën e ka shumë të dobët, është ndër rrugët e para që është asfaltuar. Shpresoj që kemi me gjetë ndonjë kërkesë në bashkëpunim me qeverinë me u bërë baza e re, sepse pas dy muajve që e rinovojmë kthehet në fazën e njëjtë.

Arbër Halilaj tregoi se i ka dy çështje: E para është që flitet për një fenomen shqetësues, pirja e duhanit nga mcaxhmenti dhe staf i administrativ i QKMF-së, si informatë e kam lexuar në nacionale.com. Këtë shqetësim mund ta drejtoj edhe përmes emailit zyrtar. Dhe e dyta, kam biseduar me ju z. kryesues më herët që Komuna e Drenasit të ketë një statut të plotësuar, sepse ky i vitit 2008 është i mangët në shumë çështje, sepse me 18 vite bëhen zhvillime të ndryshme shoqërore që duhet të reflektojmë, dhe kisha kërkuar që në cilëndo nga seancat e radhës të votojmë një propozim-vendim për ndryshim dhe një komision, ku pavarësisht a do të jem pjesë e komisionit apo jo, kisha me i dërguar amendamente që statuti të jetë shumë më i plotësuar.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se, përgjegjësia për dënimin ose jo për pirjen e duhanit është e Ministrisë së Shëndetësisë. Ka qenë përgjegjësi komunale, ka kaluar në përgjegjësi të Ministrisë së Zhvillimit Rural dhe tash është të Ministria e Shëndetësisë. Nuk është gjest i mirë me pi duhan brenda hapësirave të mbyllura, por besoj që drejtoresha do të interesohet për këtë çështje. Sa i përket statutit, duhet të kuptoni një gjë të gjithë ju: emri kushtetues i komunës sonë është Glllogoc. Unë kam dashur ta ndryshoj me asamblenë e vitit 2017 u formua komisioni, por nuk ka ecur për shkak të emrit. Ne vazhdojmë me emrin kushtetues sepse nuk mundemi ta ndërrojmë emrin kushtetues, por ta bëjmë statutin pa u bërë të varur. Prandaj, dakord

që në mbledhjen tjetër të mendojmë bashkë me ju si të bëjmë komisionin, sepse ka nevojë të trajtohen shumë tema dhe ta bëjmë një statut i cili është në harmoni me ligjin.

Arbër Halilaj thotë që unë e pata sa i përket neneve dhe përmbajtjes, jo për emrin, se nuk e di a mund të ndryshohet apo jo por ka shumë mangësi të tjera. Ndërsa të rasti në fjalë e kam fjalën për përgjegjësinë, disiplinën e brendshme, rregulloren dhe zbatimin e saj.

Mehedin Salihu tha se, i kam disa çështje, Kryetar. Për taksën komunale keni premtuar se do ta zbritni 50%, kurse faturimet janë të njëjta. Për drejtorinë e mirëmbajtjes, ujësjellësin dhe ndriçimin në shumë fshatra keni vendosur disa llamba që vetëm para fushatës janë nderur e më nuk i keni nderur fare, sepse njerëzit kanë nevojë për ndriçim. Po ashtu edhe të dëmtimet e ujësjellësit, disa thonë se kompania e ka një vit mirëmbajtje, por qytetarët kanë mbetur pa përkujdesje. Edhe e treta, kisha kërkuar prej kolegëve asamblistë p.sh. në diskutime për problemet e Likoshanit, ndërsa asamblisti i Likoshanit është këtu po i bie sikur ne e duam më shumë Likoshanin se Naimi. T'u japim hapësirë asamblistëve që janë të atyre fshatrave t'i shprehin problemet që i kanë ata.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci në këmbë folur me drejtoreshën e zhvillimit ekonomik për një rregullore që ka me përmbajtje çdo gjë qoftë për taksë dhe gurëthyes. Sa i përket ndriçimit, më thuaj ku e kemi përdorur për fushatë. Për ujësjellës, kompanitë e kanë garancionin mos me plasë gypat, jo me sjellë ujë.

Drejtori i Infrastrukturës, Endrit Gllareva sqaroi, sa i përket ndriçimit në fshatin Shtuticë, lagja Bilalli, është hera e dytë që e bëjmë kërkesën në KEDS, por nuk e di pse ju ka humbur kërkesa, mirëpo problemi ka qenë në KEDS që nuk e ka vendosur orën në këtë lagje.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se, pa u vendosur orë matësi i rrymës nga KEDS-i, nuk mundemi me i lëshuar ose me i ndalur. Dritoni e përmendi më herët për lagjen e tij në fshatin Sankoc, për besë nuk e di. Kërkoj falje publike, sepse askush nuk ka të drejtë me privilegju dikë ose me dëmtu dikë për një dritë, sepse për mua të gjithë qytetarët janë të njëjtë.

Liman Krasniqi kishte një pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës. A keni planifikuar të investoni në Komoran, të objekti shëndetësor, për një rrethrotullim, shkak i pengesave që krijohen aty. Jemi rrugë regjionale, dhe në bashkëpunim me ministritë përkatëse duhet të investohet në atë pjesë për shkak të pengesave që krijohen në komunikacion, sepse aty ndërliken dy drejtime qendra e Komoranit dhe rruga që vjen nga Komorani dhe Nekoci në atë pjesë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se i kemi bërë disa kërkesa ministrisë, por nuk kemi asgjë konkrete. Edhe sot mund të bëjmë kërkesë për këtë çështje.

Driton Ajazi kërkoi falje për ndriçimin, por të gjithë fshatarët e lagjes Ajazi edhe Hadja e kanë marrë me rezervë këtë çështje, pasi që unë kam qenë në garë si një lloj hakmarrjeje. Nuk po flas vetëm për një dritë ose një shtëpi, por po flas për rrugicën "Wesni Clark", rrugicën "Arif Shala" dhe rrugicën "Ajet Gërguri", që në total përfshijnë mbi 30 shtëpi. Nuk besoj që është kosto e

madhe me i vendos edhe 30 drita. Edhe një çështje tjetër që të keni parasysh për buxhetin e vitit të ardhshëm. Sankoci është i vetmi fshat që nuk ka asnjë pëllëmbë trotuar të shtruar. Rruga "Fazli Grajçevci", që është shumë e frekuentuar dhe ku fëmijët shkojnë në shkollë, nuk ka trotuar. Ju lus të planifikoni që në buxhetin e ardhshëm kjo rrugë të bëhet me trotuar. Për drejtorin e shkollës së mesme profesionale "Fehmi Lladrovci", sipas informatave që kam, i ka skaduar kontrata nga tetori i vitit të kaluar dhe as nuk është shpallur konkurs, as nuk i është vazhduar, ose të caktohet një ushtrues detyre.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci publikisht po të them që nuk e kam ditë për këtë çështjen e ndriçimit, por do ta hulumtojmë, sepse nuk jam i ligë me bërë kësi gjërash, pasi të gjithë qytetarët e Drenasit për mua si kryetar janë të njëjtë. Sa i përket buxhetit për trotuar, me dhjetëra herë është kërkuar nga Kadri Ajazi, por nuk kemi buxhet dhe duhet të jetë toka publike e jo private, sepse mund të na padisin në gjykatë. Unë jam kujdesur që fshatit tuaj t'ju sjell investime dhe e kam shkurtuar rrugën për ata që shkojnë në Fushë Kosovë e Prishtinë, por nuk mund të bëhen të gjitha përnjëherë. Nekoci është pa ndriçim, kemi problem me rrjetin sepse janë të lidhur me Ferizajin. Dhjetëra kërkesa i kam bërë për me u lidh, por KEDS-i nuk i lidh.

Driton Ajazit e falenderoj kryetar, për gatishmërinë për me e bërë ndriçimin në lagjen tonë. Realisht, projekti për rrugën është i jashtëzakonshëm, sepse ua ka lehtësuar jetën shumë qytetarëve të atij rajoni. Ju e keni bërë projektin si Drejtori e Infrastrukturës, ndërsa investimin e ka bërë Ministria e Infrastrukturës, kështu që faleminderit të dy palëve.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se, ka qenë zotim i imi para se me u nda buxheti, unë nuk jam i ligë me bërë dallime ndaj kundër kandidatëve.

Artian Krasniqi kishte një pyetje për rrugën "Anton Qeta" në Komoran, tha se është ende e pa asfaltuar dhe pa ndriçim dhe qytetarët kanë thënë se ka qenë premtim. Po ashtu edhe rruga "Nazmi Gashi", pse ka mbet trotuari deri në gjysmë. Kam edhe një pyetje për drejtorin Gruda: rruga "Mentor Ibriqi" është diskutuar edhe në seancën e kaluar, qytetarët atje janë prapë të shqetësuar.

Drejtori i Infrastrukturës, Endrit Gllareva e sqaroi se sa i përket rrugës "Anton Qeta", e kemi kontratën të lidhur nga viti i kaluar, por kemi një problem pronësor pasi rruga është në uzurpim. Besoj se edhe inspektorati i ka kaluar të gjitha hapat dhe së shpejti rrënohet objekti dhe vazhdojmë punimet.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci investimet kur i kemi në proces, nëse qytetarët na pengojnë, ndërprerja e projekteve bën që ato të mbesin pa u përfunduar dhe buxheti të humbë. Prandaj kërkoj ndihmën e secilit na dërgoni pyetjet me shkrim për me ju dhënë përgjigje të sakta.

Drejtori i Shërbimeve Publike, Nexhmedin Gruda tha se, e kemi diskutuar edhe në seancën e kaluar për pengesat në rrugën "Mentor Ibriqi". Pengesat janë larguar për shkak të ndihmës së shpejtë në raste emergjente pengesat po paraqesin vështirësi. Nuk ka asgjë personale këtu.

Edon Nishori theksoi se sa i përket dy kërkesave të Artianit, drejtori na ka informuar që problemi ka qenë të një shtëpi, ndërsa sa i përket trotuarit, kjo është në program për t'u bërë, por për shkak të mungesës së buxhetit dhe çështjeve tjera do të rrealizohet, besoj së shpejti.

Kryesuesi Burim Bujupi tha se, pasi nuk pati diskutime të tjera, e konsiderojmë të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

Procesmbajtësja: Fakte Hoti

Lekturoi: Nikelinda Bujupi

**Kryesuesi i Kuvendit**
Burim Bujupi